

KUJDESI PËR VETEN DHE MBROJTJA NGA TRAUMA DYTËSORE DHE EZAURIMI NË VENDIN E PUNËS

**Udhëzues për stafet që punojnë
me viktimat e trafikimit dhe dhunës...**



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Udhëzuesi “Kujdesi për veten dhe mbrojtja nga trauma dytësore dhe ezaurimi në vendin e punës” është realizuar nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E), në kuadër të projektit “Fuqizimi i stafit që punon me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën dytësore dhe konsumimin profesional” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Autor: Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Ekspert: Dr. Florian Kulla

Design & Layout: Elzana Agolli

© Shoqata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, 2024

ISBN 9789928471864

Tabela e lëndës

KUJDESI PËR
VETEN DHE
MBROJTJA
NGA TRAUMA
DYTËSORE
DHE EZAURIMI
NË VENDIN E
PUNËS

Falenderime	5
Hyrje	7
Kapitulli 1 – KONCEPTE DHE NJOHURI BAZË PËR EZAURIMIN DHE TRAUMËN DYTËSORE	10
Ezaurimi dhe trauma dytësore:.....	11
Shenja dhe simptoma:	12
Ndikimet në shëndetin mendor:	13
Lidhja mes stresit, ezaurimit dhe traumës dytësore.....	14
Cilat konsiderohen disa nga shenjat kryesore të ezaurimit? .	15
Po ju a keni kaluar apo po kaloni traumë dytësore?	15
Faktorë që mund të ndikojnë tek punonjësit në preken nga këto fenomene:	17
Reflektim personal	18
A mund të shihen traumat dytësore si mundësi për rritje të vetes?	21
Kapitulli 2 – BAZAT E KUJDESIT PËR VETEN	23
Investo për baza të shëndetshme dhe krijo vetëdije!	23
Modeli i punonjësit – Jam i fortë e i pathyeshëm	26
Kujdesi për veten: Privilegj apo përgjegjësi?	27
Pse kujdesi për veten duhet konsideruar përgjegjësi?.....	28
Pse është e nevojshme gjetja e një balance?.....	29
Kapitulli 3 – STRATEGJITË E KUJDESIT PËR VETEN	31
Strategjitë e kujdesit për veten nga trauma dytësore dhe ezaurimi	31
Ndërhyrjet strukturore	31
Zhvillimi i Vetë-kujdesit dhe Mjediset Natyrore.....	33
Kapitulli 4 – ROLI I PUNËDHËNËSVE (ORGANIZATA DHE INSTITUCIONE) NË NXITJEN E REZILIENCËS TE PUNONJËSIT DHE KRIJIMIN E NJË KLIME MBËSHTETËSE NË PUNË	40
Nxitja e mjediseve mbështetëse në punë	42
A është e rëndësishme që organizatat dhe institucionet të inkurajojnë kërkimin e ndihmës te punonjësit?	44

SHTOJCA	46
Shtojca 1 – Shkalla e ezaurimit të profesionistëve në profesionet e ndihmës	46
Shtojca 2 – Ushtrime reflektuese dhe plane veprimi	47
Shtojca 3: Strategjitë e pashëndetshme kundrejt strategjive të shëndetshme	52
Shtojca 4: Çfarë janë Kufijtë Personalë?	55
Shtojca 5: Rreziqet e punës në profesionet e ndihmës	57
Shtojca 6: Ushtrim vetëreflektimi	59
Shtojca 7: Ushtrim vetëreflektues	61
Shtojca 8: Ushtrim imagjinar	62
Shtojca 9: Plani për ndryshim	64
SHTOJCA 10: 10 minuta për të festuar gjërat e vogla	65
REFERENCA.....	66

Falenderime

Organizata Të Ndryshëm & Të Barabartë shpreh falenderime dhe mirënjohje të thellë për Ambasadën e SHBA në Tiranë, Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci për mbështetjen financiare në realizimin e këtij udhëzuesi.

Falenderojmë shumë Dr. Florian Kulla për kontributin e dhënë në përgatitjen e këtij udhëzuesi, si dhe për supervizimin klinik dhe gjithë mbështetjen që ju ka dhënë stafeve të strehëzave që ndihmojnë viktimat e trafikimit.

Vlerësim dhe mirënjohje e thellë për stafet e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik për përkushtimin, profesionalizmin, kurajon dhe punën e tyre të palodhur me viktimat e trafikimit.

Hyrje

Ky udhëzues përfaqëson një përpjekje të radhës për t'i ardhur në ndihmë atij grupi profesionistësh që punojnë çdo ditë me personat e traumatizuar si viktimat e trafikimit, dhunës dhe abuzimit.

Të dish të ndihmosh të tjerët, qofshin këta edhe individët më në nevojë të shoqërisë, ndryshe nga ç'mund të jetë perceptimi i përgjithshëm, nuk do të thotë që po me kaq lehtësi jemi në gjendje të kuptojmë dhe ndihmojmë veten tonë. Madje në mjaft raste, profesionistët më me përvojë dhe aftësi në ofrimin e shërbimeve dhe ndihmën e grupeve në nevojë mund të qëllojnë të jenë individët më neglizhentë për kujdesin ndaj vetes. Në kushte të caktuara, pa vëmendjen dhe kujdesin e nevojshëm për veten tonë, ezaurimi dhe trauma dytësore janë vetëm disa nga rreziqet e mundshme.

Përvoja na ka treguar se ezaurimi dhe trauma dytësore nuk vijnë me trumpeta. Përkundrazi, në të shumtën e rasteve vijnë në heshtje dhe tinëz, ngadalë e pa bujë. Po ashtu, shpesh nuk shfaqen në të njëjtën mënyrë apo në të njëjtën kohë te dy punonjës të ndryshëm. Tek disa, do të vijë si mungesë dëshire për të shkuar në punë; tek të tjerë, si mungesë motivimi, humbje e qëllimit dhe kënaqësisë në atë që bëjnë. Kjo tendencë është veçanërisht e dukshme te profesionistët që punojnë me individë të prekur nga abuzimi, trafikimi, dhe traumat e përjetuara nga gratë dhe vajzat në Shqipëri.

Edhe studimet në këtë fushë tregojnë se rreth 20 për qind e praktikantëve që u ofrojnë ndihmë individëve të prekur nga

këto trauma, përfshirë ata që shërbejnë në kontekstin e punës me vajzat dhe gratë e trafikuar, raportojnë nivele të larta të stresit traumatik dytësor (STS) dhe të ezaurimit në vendin e punës (burnout)¹. Evidenca bindëse theksojnë se ezaurimi shpesh vepron si parakusht për traumën dytësore, duke lënë praktikantët të prekur nga ekspozimi indirekt ndaj traumatizmit²

Ezaurimi dhe trauma dytësore janë sfida që ndikojnë në mënyrë të veçantë tek ato profesione, të cilat njihen edhe si profesionet e empatisë, në të cilat shumë prej jush angazhohen rregullisht. Këto sfida shpesh ndikojnë në emocionet dhe mirëqenien tuaj, duke kërkuar vazhdimisht aftësi të mira të menaxhimit emocional dhe resiliencës.

Njohja dhe kuptimi i këtyre fenomeneve është thelbësor për identifikimin e hershëm dhe zbatimin e strategjive efektive të përballimit dhe sistemeve mbështetëse për të zbutur efektet e tyre në shëndetin tonë mendor.

Ky udhëzues synon të ofrojë informacion praktik për punonjësit që punojnë me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën dytësore dhe ezaurimin në punë. Udhëzuesi eksploron natyrën e sfidave dhe shkaqet e tyre, por gjithashtu ofron strategji dhe burime për profesionistët në këtë fushë, që ruajnë e të kujdesen për mirëqenien e tyre, ndërsa vazhdojnë me pasion punën e

¹ Bassett, A. L. (2023). Burnout, Secondary Traumatic Stress, and Compassion Fatigue: Employees of Anti-sex-trafficking Agencies Who Work Directly With Rescued Sex-trafficked Women. [Doctoral dissertation, Liberty University]. Digital Commons @ Liberty University. <https://digitalcommons.liberty.edu/doctoral/4889>

² Cieslak, R., Shoji, K., Douglas, A., Melville, E., Luszczynska, A., & Benight, C. C. (2014). A meta-analysis of the relationship between job burnout and secondary traumatic stress among workers with indirect exposure to trauma. *Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy*, 11(1), 75–86. doi:10.1037/a0033798.


tyre të çmuar. Duke njohur dhe adresuar këto çështje kritike, ne përpiqemi të pajisim praktikantët me mjetet për të lëvizur në këto terrene të komplikuar, ndërsa mbrojnë mirëqenien e tyre.

Nëpërmjet njohurisë së përgjithshme për traumën dytësore dhe parandalimin e ezaurimit, synojmë të fuqizojmë ata që punojnë me vendosmëri për të mbështetur individët e trafikuar. Pajisja me mjete dhe njohuri për mbrojtjen e shëndetit mendor dhe emocional ndihmon në gjetjen e ekuilibrit të shëndetshëm mes kujdesit për veten dhe ndihmës profesionale për të tjerët.

KONCEPTE DHE NJOHURI BAZË PËR EZAURIMIN DHE TRAUMËN DYTËSORE



“Sofia kishte kohë që në mendje kishte vetëm mendimin se këtë punë do e bënte edhe fare pak kohë sepse do të gjente një punë tjetër. Çdo ditë e më shumë arsyet që gjente për t’u larguar nga puna, shtoheshin. Nuk i bëhej asgjë dhe shpesh i duhej të shtynte këmbët me zor që të mund të vinte në punë. Megjithatë thellë thellë një zë i brendshëm i thoshte se nuk është kaq e lehtë të “ecësh përpara” në profesion e se po bëhet gjithmonë e më e vështirë gjetja e një pune në profesion. Ajo ka ngecur mes dëshirës dhe frikës për t’u larguar. Ajo është gjithmonë e më shumë e acaruar me shefat dhe kolegët e aq më shumë me përfitueset. Nuk janë të pakta rastet kur ajo shpërthen me veten ose kolegët nga zemërimi që ndjen kur kujton se sa të rralla kanë qenë momentet kur përfitueset kanë qenë mirënjohëse ndaj saj, pavarësisht investimit të pakursyer për to. Ende e zemëron pafuqia që ndjen për të ndryshuar situatën me shumë prej vajzave dhe grave me të cilat ka punuar. Ka kohë që ka probleme me gjumin dhe peshën e kujdesin për veten. Motivimin e ka në pikën më të ulët. Kjo ngecje e saj reflektohet edhe në jetën personale. Ka kohë që jeton vetëm. Nuk beson kollaj te djemtë dhe është e kujdesshme në hapat që hedh. Kjo gjendje ka ardhur duke u përkeqësuar dalëngadalë prej disa vitesh”.



“Mira ka pak kohë që ka filluar punën në strehëz. Ajo e filloi punën me shumë dëshirë dhe kureshtje, por shpejt filloi të kuptojë se puna dhe jeta në strehëz ishte mjaft larg realitetit të shkollës, që për hir të së vërtetës nuk e kishte përgatitur mjaftueshëm për të tilla situata. Javët e para kur dëgjoji nga vetë vajzat ngjarjet e tyre, u shokua dhe sidomos njëra nga vajzat dhe historia e saj nuk i shqitej nga mendja. Javën e parë imagjinonte vazhdimisht skena nga rrëfimi i vajzës që kishte në strehëz. Kjo situatë vazhdoi me intensitet më të ulët për disa javë. Kolegët ishin të ngarkuar atë periudhë por edhe vetë ajo e gjentë të vështirë të komunikonte me ta për mënyrën si ndihej dhe se si po e përjetonte sepse kishte frikë mos shihej si e dobët, e papërvojë dhe e papërshtatshme për këtë punë. Më në fund ajo foli me supervizuesen e saj, e cila e ndihmoi shumë të kuptojë se këto përjetime u ndodhin punonjësve, edhe asaj vetë. Biseda e lehtësoi shumë Mirën.

Ezaurimi dhe trauma dytësore:

- ezaurimi i referohet kryesisht gjendjes së raskapitjes emocionale, mendore dhe fizike të shkaktuar nga ekspozimi i zgjatur ndaj kushteve të vështira të punës, gjë që shpesh rezulton në ulje të efektivitetit, përjetim shkëputjeje dhe ndjesi shterimi të energjive (fizike dhe psikike)³.
- Trauma dytësore i referohet kryesisht përfshirjes së fortë emocionale që u ndodh profesionistëve që punojnë me individë të traumatizuar. Profesionistët që punojnë me viktimat e trafikut mund të përjetojnë trauma dytësore

³ Leiter, M. P., Bakker, A. B., & Maslach, C. (Eds.). (2014). Burnout at Work: A Psychological Perspective. Psychology Press

për shkak të ekspozimit të shpeshtë ndaj historive dhe përvojave të tyre traumatike⁴.

Shenja dhe simptoma:

- Ezaurimi mund të shfaqet si raskapitje emocionale, ulje e motivimit, ndjenjë joefikasiteti, cinizëm dhe mungesë përmbushjeje në punë.
- Trauma dytësore mund të shfaqë simptoma të ngjashme me çrregullimin e stresit post-traumatik (PTSD), duke përfshirë mendime ndërhyrëse, mpirje emocionale, ankth, depresion dhe sjellje shmangëse. E thënë thjeshtë, trauma është “ngjitëse” dhe mund të “ngjitet” nga personi që e ka përjetuar te personi që po e dëgjon.

Ezaurimi dallohet kryesisht e shoqërohet me ezaurim fizik, emocional e mendor si pasojë e stresit të zgjatur dhe punës së tepërt. Profesionistët e ezauruar e gjejnë veten të mbushur nga ndjenja cinizmi, dëshira dhe fantazi për largim nga puna dhe arritje dhe produktivitet më të pakët se më parë⁵.

Trauma dytësore dhe çrregullimi i stresit traumatik dytësor i referohen shqetësimit emocional që përjeton dikush në përgjigje të shqetësimit për dhimbjen dhe jetën e të tjerëve. Ajo njihet edhe si trauma që na vjen nga shikimi ose lodhja prej dhembshurisë për të tjerët, dhe ndodh kur ne si profesionistë përjetojmë dhe përfshihemi në të njëjtat emocione si ata individë të cilët kanë kaluar trauma. Kjo ndodh kur dëgjojmë ose ekspozohemi me përvojat traumatike të atyre me të cilët punojmë, duke çuar në simptoma të ngjashme me ata që kanë përjetuar drejtpërdrejt traumën. Profesionistët që përjetojnë

⁴ <https://www.routledge.com/blog/article/understanding-second-ary-trauma-for-mental-health-professionals>
<https://www.routledge.com/blog/article/understanding-second-ary-trauma-for-mental-health-professionals>

⁵ Steele, W. (1st ed.). (Year). Reducing Compassion Fatigue, Secondary Traumatic Stress, and Burnout: A Trauma-Sensitive Workbook. Publisher.

traumën dytësore mund të ndihen si të zbratur emocionalisht për shkak të ekspozimit të përsëritur ndaj përvojave traumatike të të tjerëve. Kjo zbrazëti na bën të kemi më pak empati ndaj individëve të cilëve u shërbejmë dhe nevojë për të qenë të shkëputur emocionalisht. Ky largim mund të jetë një mekanizëm mbrojtës për të mbrojtur emocionalisht veten, ngjashëm me largimin emocional të përjetuar në traumën dytësore⁶.

Si ezaurimi edhe trauma dytësore mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien e profesionistëve, duke prekur shëndetin mendor, performancën në punë dhe jetën personale. Kjo është arsyeja pse profesionistët është e nevojshme t'i kushtojnë vëmendje kujdesit të vetes, të kërkojnë mbështetje nëpërmjet supervizimit ose këshillimit, dhe të vendosin kufij të shëndetshëm për të parandaluar ose adresuar këto çështje.

Ndikimet në shëndetin mendor:

- ezaurimi mund të çojë në stres kronik, çrregullime ankthi, depresion dhe probleme të shëndetit fizik si lodhja kronike, pagjumësia dhe problemet gastrointestinale.
- Trauma dytësore mund të rezultojë në simptoma të ngjashme me ato të ekspozuara drejtpërdrejt ndaj traumës, duke ndikuar në shëndetin mendor dhe mirëqenien e përgjithshme.

Në kontekstin e profesionistëve që punojnë me viktimat e trafikimit, shenjat e ezaurimit dhe traumës dytësore mund të ndryshojnë. Profesionistët mund të përjetojnë lodhje emocionale, lodhje që vjen nga dhembshuria, shqetësime të gjumit ose ndjenja pafuqie kur ekspozohen ndaj historive dhe përvojave traumatike të viktimave.

⁶ Miller, B. C. (2022). Reducing Secondary Traumatic Stress: Skills for Sustaining a Career in the Helping Professions. Routledge.

Lidhja mes stresit, ezaurimit dhe traumës dytësore

Në pamje të parë duket se ezaurimi dhe trauma dytësore nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë. Të krijohet përshtypja se trauma dytësore prek më shumë punonjësit e rinj, të pa stërvitur me sprovat dhe kurthet që sjellin situatat dhe ngjarjet e njerëzve në nevojë, ndërsa ezaurimi duket sikur ndodh më shumë te punonjësit e vjetër, tashmë të lodhur nga vitet e gjata të punës, nga zëri i lodhur i mos dëgjimit ndaj tyre dhe kushteve, nga stuhitë e shumta me të cilat janë përballur. Megjithatë ezaurimi dhe trauma dytësore janë goxha më të lidhura me njëra tjetrën, nga sa mund të vihet re në pamje të parë, sidomos në profesione që përfshijnë punën me individë që kanë përjetuar trauma ose sfida. Në fakt, ekspozimi i vazhdueshëm me ngjarje traumatike mund të prekë me kalimin e kohës edhe punonjësit më profesionistë, por edhe punonjësit e ezauruar ka më shumë mundësi të përjetojnë traumë dytësore si pjesë e dorëzimit të psikikës përballë ngjarjeve në punë⁷.

Ezaurimi lidhet kryesisht me stresin afatgjatë dhe hihet shpesh si sindromë e stresit afatgjatë, të pazgjidhur, që lidhet kryesisht me punën dhe mjedisin në punë.

Stresi	Ezaurimi
Karakterizohet nga mbi-angazhimi.	Karakterizohet nga mosangazhimi.
Emocionet janë tepër reaktive.	Reaktivitetin e kufizuar emocional (renie, mpirje)
Prodhon urgjencë dhe hiperaktivitet.	Prodhon pafuqi dhe mungesë shprese.
Humbje energjie.	Humbja e motivimit, idealeve dhe shpresës.
Të çon në çrregullime të ankthit.	Çon në shkëputje (Detachment) dhe depresion.
Dëmi parësor është fizik.	Dëmi parësor është emocional.
Mund të të vrasë para kohe.	Mund ta bëjë jetën të duket se nuk ia vlen të jetohe.

⁷ <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/31789880/>

Cilat konsiderohen disa nga shenjat kryesore të ezaurimit?

1. Produktivitet i ulët për të njëjtën sasi përpjekjesh
2. Mungesë fokusi, kujtesë e dobët, vëmendje e dobët
3. Orë ekstra pune për të realizuar detyrat
4. Lodhje e vazhdueshme pavarësisht pushimit
5. Mendime të fokusuara vetëm te puna edhe jashtë orarit të punës
6. Ndryshime të gjendjeve të humorit - irritim, mërzi ose zemërim
7. Ndjenja të vetmisë dhe izolimit
8. Dhimbje shpine/koke, sëmundje të shpeshta, rritje e rrahjeve të zemërs
9. Shtim i konsumimit të kafes, alkoolit, drogërave
10. Asgjë nuk bën kuptim, çdo gjë duket e pamundur
11. Sjellje riskuese
12. Shtim i cinizimit, sjellje si robot, shqetësime emocionale⁸

Po ju a keni kaluar apo po kaloni traumë dytësore?

1. **Stres Emocional:** shfaq shenja të stresit emocional, si trishtim i vazhdueshëm, ndryshime të shpeshta të humorit, ose shpërthime të papritura që nuk kanë lidhje me situatën aktuale.
2. **Ankth dhe Stres:** shfaq simptoma të ankthit, stresit, ose hipervigjilencës
3. **Shmangie** ndaj Situatave të caktuara: shmang klientë, tema ose situata që I kujtojnë përvojat traumatizuese

⁸ Mayo Clinic Staff. (n.d.). Job burnout: How to spot it and take action. Mayo Clinic. Retrieved from <https://www.mayoclinic.org>
PositivePsychology.com. (n.d.). Warning Signs of Burnout: 11 Reliable Tests & Questionnaires. Retrieved from <https://positivepsychology.com>

4. **Ndryshime në Marrëdhënie:** shfaq ndryshime në marrëdhënie me kolegët, nivel në rritje të konflikteve me ta, një lloj tërheqjeje nga marrëdhëniet sociale, ose shmang bisedat për punën.
5. **Simptoma Fizike:** dhimbje koke, lodhje, ndërprerje ose vështirësi me gjumin, ndryshime në oreks që nuk lidhen me arsye të tjera shëndetësore.
6. **Ulje e Empatisë:** shfaq ulje të empatisë ose bashkëndjnjës ndaj klientëve, kolegëve, ose të tjerëve, që nuk është tipike për sjelljen e tij/saj.
7. **Mendime Ndërhyrëse (Intruzive):** Përjeton mendime intruzive, flashback-e, ose kujtime të lidhura me ngjarje traumatizuese ose me incidente të dëshmuara apo të dëgjua nga viktimat e trafikimit që ndikojnë në aftësinë e tij/saj për t'i përqendruar apo fokusuar në detyra.
8. **Mpirje Emocionale:** shfaq mpirje të emocioneve dhe një lloj largimi emocional si nga puna edhe nga situata që më parë i jepnin emocion.
9. **Shtim i Zemërimit dhe Irritimit:** shfaq më shumë irritim, frustrim, e zemërohet për gjëra të vogla për të cilat më parë nuk shqetësohej aspak.

Njohja e këtyre shenjave paralajmëruese është jetike për profesionistët në këtë fushë. Inkurajimi i tyre që të jenë të vëmendshëm ndaj ndryshimeve në disponimin, sjelljen dhe mirëqenien emocionale mund të ndihmojë në identifikimin e shenjave të hershme të ezaurimit apo traumës dytësore. Njohja e këtyre shenjave mund të ndihmojë punonjësit në ofrimin e mbështetjes dhe ndërhyrjeve të përshtatshme për të adresuar si ezaurimin edhe traumën dytësore.

Po ju – a jeni “në një rrugë të mbarë” drejt ezaurimit?

- Çdo ditë në punë është “një ditë e keqe”.
- Kujdesi për punën dhe jetën ju duket energji e shpenzuar kot.
- Jeni i/e lodhur pjesën më të madhe të kohës.
- Pjesën më të madhe të ditës e shpenzoni në detyra që ju duken të kota dhe lodhëse.
- Ndjeni se çdo gjë që bëni nuk bën ndonjë ndryshim dhe nuk vlerësohet nga askush.

Faktorë që mund të ndikojnë tek punonjësit në prekjen nga këto fenomene:

Disa faktorë të mundshëm që mund të kontribuojnë në cënueshmërinë tonë më të madhe nga trauma dytësore dhe ezaurimi janë:

- **Historia e Traumave të Mëparshme:** Përvojat tona të mëparshme me ngjarje apo trauma të ngjashme ndikon fort në ndjeshmërinë e tonë.
- **Mosha dhe Vetëefikasiteti:** Profesionistët më të rinj, sidomos ata që mendojnë dhe e shohin veten si të paaftë dhe jo efikas në punë, përballen me risk të shtuar.
- **Konteksti i Punës:** Punë e përbashkët në grup ku nuk është e qartë kush bën çfarë, kufizimet organizative dhe konfliktet ndikojnë në ndjeshmëri të shtuar ndaj këtyre fenomeneve.
- **Roli i Kontrollit dhe Mbështetjes:** Kontrolli më i madh personal dhe organizativ, i bashkuar me mbështetje sociale të forta, luajnë role të rëndësishme në nxitjen e angazhimit në punë dhe reziliencës.

Ka edhe një sërë të tjerë faktorësh që mund të kontribuojnë në stresin afatgjatë dhe ezaurimin në punë. Shpesh ato nuk adresohen mjaftueshëm në literaturë, por ata japin ndikimin e tyre te punonjësit me kalimin e kohës.

- Trajtimi i padrejtë
- Ngarkesa (kërkesa) të pamënaxhueshme në punë
- Paqartësi dhe konflikt rolesh
- Mungesa e komunikimit dhe mbështetjes
- Mungesa e mbështetjes sociale
- Presion i panevojshëm kohe
- Mungesa e feedback-ut
- Pjesëmarrja e ulët në vendimmarrje
- Mungesa e burimeve të nevojshme
- Monotonia e punës
- Ndjenja se ke pak/aspak kontroll mbi punën që bën
- Mjedisi I paorganizuar e me presion të lartë
- Faktorë personalë si stili I jetës, tiparet e personalitetit
- Tendenca perfeksioniste⁹.

Reflektim personal

Shpesh e gjej ezaurimin dhe traumën dytësore brenda analizës së mekanizmave të pavetëdijshëm mbrojtës. Këto mekanizma të pavetëdijshëm të mbrojtjes shpesh ndodhin pa vetëdijen e punonjësit dhe mund të kenë ndikim në mirëqenien e tij, si dhe në ndërveprimet e tij profesionale. Njohja dhe adresimi i këtyre mekanizmave mund të jetë jetik në mbështetjen e këtyre punonjësve dhe zbutjen e efekteve të ezaurimit dhe traumës dytësore.

1. Jashtëzimi: term kryesisht i përdorur në teorinë psikoanalitike që përshkruan tendencën për të projektuar gjendjet tona të brendshme në botën e jashtme. Është mekanizëm mbrojtës i pavetëdijshëm, e personi që e

⁹ Moss, J. (2021). *The Burnout Epidemic: The Rise of Chronic Stress and How We Can Fix It*. Harvard Business Review Press.

përdor nuk është i vetëdijshëm që po e përdor.

Shembuj nga praktika të përdorimit të jashtëzimit:

- *I gjithë faji është i përfitueseve, jo i joni.*
- *Faji për këtë vështirësi është i shtetit dhe strukturave shtetërore, jo i joni.*
- *Faji për këtë situatë dhe dështim është i drejtuesve dhe i kolegëve por jo i joni.*
- *Faji për gjendjen është i kushteve (godinës, pagës, mbingarkesës) jo i joni.*

2. Zhvendosja: një mekanizëm mbrojtës në të cilin një person ridrejton një reagim emocional nga personi apo objekti për të cilin ndjen dicka tek një person apo objekt tjetër.

Shpesh shoh se punonjësit mund të zhvendosin frustrimin dhe stresin nga marrëdhëniet në punë me viktimat te anëtarët e familjes ose persona të tjerë të jetës së tyre. Ata mund të shfaqin zemërim në shtëpi, duke riorientuar pa vetëdije agresionin emocional nga puna në marrëdhëniet personale.

Në raste të tjera kam vënë re se dështimi në ndihmën ndaj viktimave të trafikimit mund të shfaqet si frustrim ose fajësim ndaj vetë viktimave, duke transferuar pa vetëdije emocionet e tyre të pa zgjidhura te ata persona që duhet t'i ndihmojnë.

3. Projektimi: është një mekanizëm mbrojtës në të cilin një individ njih tiparet ose impulset e tij të papranueshme tek dikush tjetër për të shmangur pranimin e atyre tipareve te vetja.

Kam vënë re që disa punonjës që përjetojnë ndjenja faji ose dyshimi për veten për dështimet e perceptuara në ndihmën e viktimave mund të projektojnë pa vetëdije këto ndjenja te kolegët, duke atribuar përgjegjësinë ose mungesën e aftësive të tyre te të tjerët. Të tjerë punonjës që përballen me ezaurim dhe shqetësime emocionale mund të projektojnë pa vetëdije stresin emocional

te përfituesit (viktimat e trafikimit ose dhunës), duke perceptuar reagimet emocionale të viktimave si të pavlera ose të parëndësishme, në vend të njohjes dhe adresimit të konfliktit të tyre të brendshëm.

4. Racionalizimi: mekanizëm mbrojtës kur dikush justifikon sjelljen apo veprimet e tij duke dhënë arsye apo shpjegime të logjikshme edhe pse ka arsye të tjera për sjelljen. Disa punonjës mund të racionalizojnë kur shtojnë oraret apo ngarkesën e punës duke i justifikuar si sakrifica të nevojshme për të ndihmuar përfituesit. Ata përpiqen në këtë rast të bindin dhe veten e tyre se këto përpjekje të shtuara janë shumë të nevojshme, duke injoruar nga ana tjetër vështirësitë që mund t'i dalin në mirëqenien personale apo menaxhimin e jetës së përditshme.
5. Mohimi: përfshin refuzimin për të pranuar realitetin ose pranimin e ekzistencës së një problemi ose një situatë stresuese. Mund të shfaqet si një refuzim i drejtpërdrejtë për të njohur një çështje ose si minimizim i rëndësisë së tij. Ata punonjës që përdorin këtë mekanizëm mbrojtës i gjej shpesh të mohojnë stresin e shkaktuar nga natyra e vështirë e punës duke thënë “është thjesht pjesë e punës” “jemi mësuar e nuk e kemi fare problem” duke refuzuar të kuptojnë dhe pranojnë ndikimin që ka në mirëqenien e tyre. Të tjerë punonjës mund të mbajnë fort ose largojnë ndjenjat e trishtimit, dhimbjes a lëngimit apo zemërimit ndaj historive apo situatave të viktimave, duke pretenduar se nuk preken më nga historitë e dhimbshme.
6. Rregresioni: Nën stres ose presion, punonjësit mund t'i rikthehen modeleve të mëparshme të sjelljes ose mekanizmave të përballimit që ishin efektive në të kaluarën, por mund të mos jenë të përshtatshëm për situatën aktuale. Këtë mekanizëm mbrojtës e gjej shpesh në raste që një punonjës në regresion mund të bëhet pak si fëmijë dhe të kërkojë rehati ose siguri të tepërt nga kolegët, duke shfaqur sjellje të ngjashme

me kërkesën për mbështetje prindërore në momentet e mërzitjes. Një formë tjetër e shfaqjes së regresionit është lënia e vendimeve drejtuesve duke treguar rezistencë në marrjen e vendimeve të pavarura edhe pse është në kompetencën e tyre të punës.

7. Kompensimi: Kur dikush ndihet i papërshtatshëm në një fushë, ai mund të mbitheksojë ose të shkëlqejë në një fushë tjetër për të kompensuar mangësitë e perceptuara. Disa punonjës e kompensojnë ankthin e tyre duke u angazhuar më shumë në punë, duke marrë më shumë përgjegjësi ose duke punuar më shumë orë, duke u përpjekur të tregojnë kompetencën dhe vlerën e tyre përmes përkushtimit të tyre. Ndërkohë punonjës të tjerë mund ta shfaqin kompensimin në situata ku nuk kanë mundësi të kontrollojnë situatat e traumës të viktimat, në vend të kësaj ata kontrollojnë më shumë sec duhet aspekte të punës që janë nën kontrollin e tyre si psh ndjekin me saktësi procedurat rutinë, rregullat e punës etj.
8. Sublimimi: Ky mekanizëm mbrojtës përfshin kanalizimin e impulseve ose emocioneve potencialisht shkatërruese në aktivitete më të pranueshme nga shoqëria ose më produktive. Një ndër format e shfaqjes së sublimimit që gjej më shpesh është kanalizimi i stresit dhe lodhjes emocionale në zhvillimin e strategjive të reja të ndërhyrjes ose programeve apo ndërhyrjeve për të ndihmuar viktimat. Këta punonjës shfrytëzojnë energjinë emocionale në punë konstruktive në dobi të viktimave, duke e përdorur ankthin e tyre si një katalizator për ndryshime pozitive.

A mund të shihen traumat dytësore si mundësi për rritje të vetes?

Ngjashëm me shprehjen e Nices se “ajo që nuk më vret më bën më të fortë” apo shprehjen se “detet e qeta nuk bëjnë detarë të zotë” ka autorë që shohin edhe anët pozitive të ngjarjet

traumatizuese, të cilat edhe mund ta forcojnë individin që i përjeton.

Autorë si Tedeschi dhe Calhoun¹⁰ (2004) e lidhin me konceptin e rritjes posttraumatike. Për shumë individë që përjetojnë trauma dytësore në përgjithësi përvetësojnë vlerësim më të madh për jetën, zgjerojnë perspektivën dhe kuptimin për jetën pas ngjarjeve të tilla. Shumë punonjës me traumë dytësore mësojnë të vlerësojnë më mirë atë që kanë, mësojnë të vlerësojnë më shumë rolin e tyre në ndihmën ndaj të tjerëve, e mësojnë të jenë në përgjithësi më të kënaqur me veten e tyre. Në shumë raste e shohin veten si më të rritur e më vlerësues ndaj vetes kur shohin se kanë mundësinë të lehtësojnë në një mënyrë të caktuar jetën dhe dhimbjen e dikujt.

E njëjta situatë ndodh me profesionistë të shëndetit mendor dhe psikoterapistët, mjekët, infermieret. Edhe pse mund të jenë shumë të shqetësuar dhe të lodhur nga puna e mund të vuajnë edhe vetë nga ankthi, depresioni e pagjumësia, ata ndihen të përmbushur, me qëllim në jetë, dhe krenarë që kanë mundësi të jenë në një pozicion ku mund të lehtësojnë shqetësimin psikologjik apo fizik të atyre për të cilët po kujdesen.

Sigurisht që të kujdesesh për të tjerët ka kostot e veta emocionale, qofshin këta klientë, pacientë apo familjarë apo situata që kërkojnë ndërhyrje urgjente profesionale. Mbase kjo lodhje nga dhembshuria është cmimi i të qenit njeri

¹⁰ Tedeschi, R. G., & Calhoun, L. G. (2004). Posttraumatic growth: Conceptual foundations and empirical evidence. *Psychological Inquiry*, 15(1), 1-18.

BAZAT E KUJDESIT PËR VETEN

Nela e pa veten në një pozitë të vështirë pas 10 vitesh në punën me viktimat e trafikimit. Pas një analize të gjatë me veten kuptoi se nëse nuk bënte ndryshime rrënjësore, do t'i duhej ta linte punën, por për të kjo nuk ishte vetëm një punë. I gjithë identitetit i saj lidhej fort me këtë punë. Ajo e dinte se kjo punë e kishte ndihmuar po aq shumë sa e kishte lodhur. Nela vendosi që në planin e vitit pasues të përfshinte objektiva dhe mori vendime të cilat nuk do t'i negocionte për asnjë arsye. Ajo e vendosi kujdesin dhe kohën për veten në plan të parë. Mësoi meditimin dhe jogën, mësoi të vendosë kufij të shëndetshëm të orareve dhe sasisë së punës e nuk e merrte më punën me vete, edhe nëse raportet duheshin mbyllur të nesërmen. Pas një periudhe disamujore investimi, ajo filloi të rigjejë shumë nga përjetimet e bukura dhe atë përmbushje që gjente në vitet e para në punë.

Investo për baza të shëndetshme dhe krijo vetëdije!

Në vëzhgimin dhe dëgjimin e punonjësve kam parë se kjo punë pavarësisht se është shumë interesante dhe rritëse, ka vështirësitë e veta si oraret e gjata, telefonatat *on call*, surpriza dhe befasi të pakëndshme, ku çdo ditë vështirë të ngjajë me tjetrën. Shumica e programeve që trajtojnë ezaurimin dhe traumën dytësore, përpiqen t'u sugjerojnë punonjësve këshilla dhe hapa konkretë për t'u angazhuar në punën me veten, për

të krijuar kufij të qartë mes punës dhe vetes/familjes, apo angazhime konkrete në hobi, sporte, programe të jogës e meditimit apo përfshirje në grupe sociale.

Në përvojën time, përpara se të shohim se çfarë programesh apo strategjish do të na bënin mirë do të doja të reflektonim pak për investimin në baza të vërteta të shëndetshme të kujdesit për veten.

Rëndësia e krijimit të vetëdijes, njohjes së thellë të vetes dhe krijimit të vetë vlerësimit pozitiv për veten.

Në njohjen time të deritanishme të pjesës më të madhe të punonjësve, askush nuk është në këtë profesion dhe punë rastësisht apo për të fituar përvojë apo vetëm nga nevoja për pagën. Secili nga ne ka arsyet e veta, të thella e shpesh të pavetëdijshme pse vazhdojmë të qëndrojmë në këtë vend pune apo fushë profesionale. Secili nga ne ka arsyet e veta....

Për dikë puna është ishulli ku fshihet për t'u arratisur nga problemet e familjes dhe shoqërisë së tij, për dikë tjetër është vendi ku ndihet më i dobishëm dhe i mirë në jetë, për dikë vendi ku i jep kuptim jetës dhe qëllimit të tij, për dikë tjetër "burgu" ku ka ngecur, për dikë çelësi që i hap çdo portë. Për dikë vendimmarrja për të ndihmuar viktimat e trafikimit dhe dhunës mund të lidhet me pafuqinë e përjetuar dikur si fëmijë për të ndihmuar njerëz a familjarë në pozicione të ngjashme, për dikë tjetër lidhet me trauma e përjetime të ngjashme të fëmijërisë së vet.

Edhe roli i ndihmuesit apo profesionistit të empatisë nuk ka ardhur kaq rastësisht. Ai nuk krijohet vetëm nga shkolla që kemi ndjekur apo trajnime të tjera. Për shumicën e punonjësve kam vënë re se ata e kanë bërë rolin e terapistit, zgjidhësit të konflikteve, njeriut të mirë, ofruesit të ndihmës së pakursyer, personit që kurrë nuk e lë dikë në baltë, që vendos nevojat e tjetrit në vend të nevojave të vetes në vend të parë, që nuk di

të thotë asnjëherë jo, prej vitesh, shpesh pa e ditur dhe kuptuar në familjen e tyre, në klasën apo fisin e tyre. Rolet krijohen dhe ndërtohen herët në jetë e shpesh zgjedhjet që bëjmë, lidhen me këto role të hershme të cilat mund të na jenë dhënë.

Për këtë arsye, është e nevojshme të marrim kohë të rregullt të njohim veten në nivele më të thella, për të kuptuar si na janë plotësuar nevojat gjatë fëmijërisë dhe sa seriozisht i marrim ne nevojat tona sot si të rritur. Në shumë raste, pavarësisht përpjekjeve shumë punonjës bien pre e modeleve të vjetra të mos kujdesit ndaj vetes.

Mungesa e kujdesit dhe neglizhenca ndaj vetes lidhen me shumë faktorë, por një ndër faktorët kryesorë është nëse prindërit tanë kanë qenë neglizhentë ndaj nevojave tona. Modelet tona të hershme për mënyrën sesi merren në konsideratë nevojat tona ndikojnë edhe në moshën e rritur dhe pavarësisht se mund të jemi mjaft të aftë të ndihmojmë të tjerët, mund ta gjejmë veten në vështirësi për të ndihmuar veten në plotësimin e nevojave tona.

Në përgjithësi individët e neglizhuar, edhe pse mund të jenë profesionistë të mirë, mund të hasin vështirësi në njohjen dhe përmbushjen e nevojave të tyre emocionale, mund të kenë vështirësi në formimin e marrëdhënieve të shëndetshme, ose të hasin vështirësi në shprehjen emocionale. Ata mund të kenë mungesë apo vetëvlerësim të ulët. Si të rritur, ata mund të vazhdojnë të neglizhojnë veten duke mos e vlerësuar kujdesin ndaj vetes ose duke angazhuar në sjellje autodestruktive. Për shkak të neglizhencës, këta individë mund t'a gjejnë sfiduese të kërkojnë ndihmë apo mbështetje. Kjo ndodh sepse thellë brenda vetes ata ende mund të besojnë se nuk meritojnë ndihmë ose të kenë frikë se do të jenë barrë për të tjerët.

Një tjetër çështje që vjen si pasojë e neglizhimit është problemi me kufijtë. Punonjësit në profesione ndihmëse mund të kenë vështirësi në vendosjen e kufijve midis jetës personale dhe profesionale. Ata sakrifikojnë kohën personale dhe neglizhojnë

nevojat e tyre për të përmbushur kërkesat e klientëve ose pacientëve. Të tillë profesionistë e gjejnë të vështirë të krijojnë balancë mes jetës profesionale dhe jetës personale.

Ndaj është me rëndësi që në këtë punë që bëni të gjeni mundësitë për të punuar vazhdimisht në njohjen dhe mbështetjen e vetes përmes coaching, terapisë individuale dhe të grupit, supervizimit, supervizimit mes kolegësh etj. Adresimi i këtyre sfidave përfshin njohjen e ndikimit të neglizhencës së fëmijërisë në sjelljet e të rriturve dhe njohjen e mënyrave të veçanta se si profesionistët në role ndihmëse mund të neglizhojnë veten. Inkurajimi i praktikave të kujdesit ndaj vetes, promovimi i kufijve të shëndetshëm, avokimi për balancën midis jetës së punës dhe përvetësimi i aftësisë për të kërkuar ndihmë për shëndetin mendor, janë hapa të rëndësishëm në zbutjen e neglizhencës, për të rriturit e neglizhuar dhe për profesionistët në role të kërkuara.

Modeli i punonjësit – Jam i fortë e i pathyeshëm

Një tjetër model punonjësish të cilët i shoh në rrezik, si ndaj ezaurimit, ashtu dhe ndaj traumës dytësore, janë ata që mendojnë se janë kaq të fortë e të pathyeshëm dhe të pandikueshëm nga çfarë ndodh jashtë, rreth dhe brenda tyre, aq sa edhe të tjerët besojnë se mund të durojnë gjithçka. Shpesh iluzioni, neglizhimi por edhe nevojat narcistike i bëjnë të mendojnë se nuk preken nga këto fenomene dhe e kanë të gjithë situatën në kontroll. Ky grup punonjësish është edhe më i rrezikuar sepse për të mbrojtur “reputacionin e mirë” kanë turp të pranojnë se edhe ata mund të vuajnë nga ezaurimi dhe trauma dytësore. Madje shpesh kjo thyerje në sistemin e tyre mbrojtës mendor është e menjëhershme, me panik dhe situata dhe emocione që l dalin prapritur nga kontrolli, duke l gjetur plotësisht të papërgatitur për këtë realitet të ri.

T'u japësh kuptim gjërave që bën

- Kujtohu të të drejtojë pasioni, jo frika
- Kujtohu t'u japësh kuptim e të gjesh kuptim në gjërat që bën dhe jo për mbijetesë
- Kujtohu që emocionet dhe sjellja janë ngjitëse.
- Përzgjidh njerëz me frymë të njëjtë dhe jo shterues
- Mos harro se shëndeti dhe koha janë dy dhurata të shtrenjta të jetës.
- Shijo gjërat e vogla që ke, mos qaj për ato që nuk ke ende.

5 mënyra për t'u dhënë kuptim gjërave

1. Bëji me pasion e qëllim gjërat që bën.
2. Zhvillo dhe përmirëso marrëdhënie sociale domethënëse e të qëllimshme.
3. Ndërto marrëdhënie që rrisin ndjenjën e përkatësisë e janë domethënëse.
4. Monitoro gjendjen shpirtërore dhe krijo koherencë
5. Merr në zotërim mjedisin tënd me koherencë.

Kujdesi për veten: Privilegj apo përgjegjësi?

Në sferën e profesioneve të dedikuara për të mbështetur viktimat e trafikimit dhe dhunës, koncepti i kujdesit për veten ndodh shpesh që të shihet nga punonjësit si egoizëm apo privilegj dhe jo si përgjegjësi për veten. Si profesionistë, përgjegjësitë tona për individët e rrezikuar të cilëve u shërbejmë janë të mëdha, dhe shpesh ideja e kujdesit për veten tonë mund të duket si luks, e privilegj i tepërt. Megjithatë, nëse e shohim kujdesin për veten si privilegj që i bëjmë vetes, por edhe si përgjegjësi për veten, kjo qasje na ndihmon të ruajmë më mirë mirëqenien tonë gjatë punës në këto role sfiduese. Është një koncept shumëdimensional që duhet të pranohet në mënyrë kolektive brenda fushës sonë. Duke njohur dhe

adresuar nuancat e kujdesit për veten, ne fuqizojmë veten për të ofruar mbështetje më të ndjeshme, më të qëndrueshme, dhe më efektive për ata që kanë nevojë për ne.

Për ata punonjës që e gjejnë veten të zhytur në punë që nuk mbarojnë kurrë, përherë në presion për të bërë shumë gjëra në kohë, shpesh me burime të pamjaftueshme financiare apo kohe, prioritizimi i hapësirës për veten shihet si një privilegj i paarritshëm. Por pavarësisht të gjitha rrethanave dhe kushteve në të cilat mund të jemi, krijimi i kohës për veten është investimi më i mençur dhe i domosdoshëm që mund të bëjmë. Vendimi për të ndihmuar dhe kujdesur për veten lidhet me faktin sa seriozisht i marrim nevojat tona, sa të aftë jemi të dëgjojmë trupin dhe mendjen tonë kur I shfaqin këto nevoja në mënyrën e tyre, dhe mbi të gjitha konceptimi i nevojave tona si një e drejtë njerëzore. Tek e fundit nëse nuk mësojmë të duam veten e të kemi empati e dhembshuri për veten, si mund të pretendojmë se kemi empati të vërtetë për të tjerët? Ndaj prioritizoni kujdesin për veten, pavarësisht burimeve që mund të keni në dispozicion, sepse nevoja për të mbajtur veten të shëndetshme është një nevojë themelore universale.

Pse kujdesi për veten duhet konsideruar përgjegjësi?

Aftësia jonë për të mbështetur efektivisht viktimat e trafikimit a dhunës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vetë mirëqenien tonë si individë. Neglizhimi i mirëqenies sonë mund të kompromentojë cilësinë e kujdesit që ofrojmë. Ta shikosh kujdesin për veten si përgjegjësi do të thotë të pranosh se ruajtja e shëndetit mendor e fizik duhet të jetë prioritet, jo vetëm për hir të vetes sonë, por edhe për hir të atyre që synojmë të ndihmojmë. Duke prioritizuar kujdesin për veten tonë, ne vlerësojmë përgjegjësinë që kemi për veten dhe ata të cilëve u shërbejmë. Është një angazhim për shërbim të qëndrueshëm dhe të përkushtuar.

Pse është e nevojshme gjetja e një balance?

Kujdesi për veten dhe shikimi i tij jo si privilegj por si përgjegjësi, kërkon që ne të përpiqemi vazhdimisht të gjejmë një balancë mes kujdesit për veten dhe kujdesit për të tjerët. Kjo balancë kërkon qasje krijuese që i përshtatet kushteve në të cilat jemi.

Gjetja e një balance mes kujdesit për të tjerët dhe për veten merr rëndësi më të veçantë sidomos për punonjësit që punojnë me viktimat e trafikimit dhe dhunës.

Disa nga arsyet kryesore që mendoj se lidhen me rëndësinë e gjetjes së balancës janë:

- ruajtja e balancës sjell qëndrueshmëri më të gjatë profesionale pa u prekur nga ezaurimi;
- kur jemi mirë me veten jemi më efektivë e ofrojmë kujdes më të mirë ndaj përfituesve;
- aftësia jonë për të bashkëndjerë dhe për të komunikuar në mënyrë efektive me viktimat rritet.
- Forcohet rezilienca personale, gjë që i lejon punonjësit të përballen më mirë edhe në kushte të vështira pune.
- Modelojmë role më të mira të kujdesit për veten te personat të cilët mbështesim (Profesionistët që e vlerësojnë kujdesin për veten japin një shembull pozitiv për viktimat. Ata demonstrojnë kufij të shëndetshëm, mekanizma përballimi dhe respekt ndaj vetes, duke inkurajuar viktimat indirekt për të vlerësuar mirëqenien e tyre).
- Kujdesi për veten zvogëlon riskun për trauma dytësore.
- Balancimi i kujdesit lejon profesionistët të vendosin dhe të mbajnë kufij, duke parandaluar lodhjen emocionale dhe duke u mbrojtur nga stresi.
- Kujdesi për veten lejon profesionistët të kenë një impakt të vazhdueshëm dhe më të gjatë në mbështetjen e viktimave të trafikut.
- Duke u kujdesur për veten, ata mund të vazhdojnë punën e tyre në mënyrë të qëndrueshme pa përjetuar ezaurim

